

**RESEMANTICIZATION OF MYTH OF APHRODITE, DODONA AND
AURORA IN LINDITA AHMETI'S POETRIES
RISEMANTIZIMI I MITIT MBI AFËRDITËN, DODONËN DHE
AUROREN NË KRIJIMTARINË E LINDITA AHMETIT**

Kaltrina SADIKU¹

¹ Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: kaltrina.sadiku@unite.edu.mk

Abstract

In this paper it is been given an explanation about the resemanticization of myths of Aphrodite, Dodona and Aurora on Lindita Ahmeti's poetries. It's been analyzed how the author retakes and how she resemanticizes these myths, which give her poetries an expressive force and beautifulness. It's been analyzed what meaning these myths take when they are placed on an Albanian environment, it's been analyzed how through them the author in some poetries expresses her concern for the fate of her nation and homeland, how the concern of the lyrical subject for its fate and for the fate of her language is given simultaneously in poetry, using as suggestion certain segments of the above-mentioned myths.

Through these resemanticized myths will be understood how the lyrical subject sees the enemies of the nation and the language, what the lyrical subject suggests to overcome the danger that threatens the language and the nation from these enemies. It will be understood where does the lyrical subject finds hope. These myths will often be revived to play the role of witnesses of history, of hidden truth, of lost territories which even today are not separated culturally, nationally and emotionally from Albania. These myths will also become a proof of our rich culture which is best evidenced by the language which is as it is said the language of the mythical ancestors Cadmus and Harmony.

Keywords: *resemanticization, myth, culture, language, nation.*

Përmbledhje

Në këtë punim është folur për risemantizimin e mitit mbi Afërditën, Dodonën dhe Aurorën në krijimtarinë e Lindita Ahmetit. Është analizuar si autorja i rimerr dhe i risemantizon këto mite të cilat i japin ngjyrë e forcë shprehëse vargut të saj. Është analizuar kuptimi që marrin ato të vendosura në ambient shqiptar, është analizuar mënyra se si jepet përmes tyre në disa poezi brenga e autores për fatin e kombit dhe të atdheut të saj, se si jepet njëkohësisht në poezi brenga e subjektit lirik për fatin e saj dhe për fatin e gjuhës së saj amë duke përdorur si sugjestiologji segmente të caktuara të miteve të lartpërmendura. Përmes këtyre miteve të risemantizuara do të kuptohet qëndrimi i subjektit lirik lidhur me armiqtë e kombit dhe gjuhës; do të kuptohen sugjerimet e subjektit lirik për kapërcimin e rrezikut që i kanoset gjuhës dhe kombit nga të tillët dhe do të kuptohet ku varet shpresa e subjektit lirik. Këto mite shpeshherë do të rimerren për të luajtur rolin e dëshmitarëve të historisë, të së vërtetës së fshehur, të territoreve të humbura të cilat edhe sot frymojnë shqip dhe të kulturës sonë të pasur për të cilën dëshmon më së miri gjuha e cila është siç thuhet gjuha e të parëve mitik Kadmit dhe Harmonisë.

Fjalët kyçe: *risemantizimi, miti, kultura, gjuha, kombi.*

1. Afërdita

Një nga mitet që më së shpeshti e shohim të rimarrë në krijimtarinë e Lindita Ahmetit është miti mbi Afërditën (hyjneshtë e dashurisë, e pllenimit dhe e bukurisë. Sipas Homerit, Afërdita ishte e bija e Zeusit dhe e Dionës. Sipas një legjende më të përhapur, që e gjejmë te Hesoidi, ajo doli nga shkuma e detit, prandaj shpesh edhe i ngjitej epiteti Afërdita anadiomena, që do të thotë e dalë nga deti. Afërdita nderohej edhe si hyjneshtë e detit dhe mbrojtëse e lundrimit. Kulti i Afërditës u soll në Greqi nga Lindja prej Fenikasve.⁵⁴

Miti mbi Afërditën është rimarrë në veprën “Mjedra dhe bluz”, në poezinë “Duke ndërtuar qytetin e huaj” për të treguar bukurinë e rrallë të shtatoreve në një qytet të huaj me rrugë diellore, kisha e xhami, ku subjekti lirik shkruan librin e huaj e ndihet e huaj, e robëruar e lidhur me një zinxhir të artë për qafe, megjithëse në shtëpinë e saj. Subjekti lirik duke folur për shtëpinë përmend treshi i shkretë. Kur përmendet treshi, na kujtohen personazhe të ndryshme që duhet të bëjnë një zgjedhje mes tre njerëzish, situatash, kushtesh.

Kur flet për këtë fenomen dhe shkaqet e tij Frojdi ndër të tjera thotë: “Menjëherë na vijnë ndërmend skena të tjera nga mite, përralla dhe krijime letrare, të cilat kanë si përmbajtje të njëjtën situatë: bariu Paris duhet të përzgjedhë midis tri perëndeshave, prej të cilave e shpall perëndeshën e tretë si më të bukurën. Hirushja është po ashtu vajza e re të cilën djali i mbretit e preferon para dy motrave më të mëdha në moshë. Psikja në përrallën e Apulejus është më e reja dhe më e bukura prej tri motrave.

Duhet të na tërheqë vëmendjen fakti që ajo e treta, e shkëlqyera në shumë raste, përveç bukurisë ka edhe disa veçori. Janë veti që duket se synojnë arritjen e ndonjë uniteti. Sigurisht, ne s’duhet të presim t’i gjejmë ato njëlloj të spikatura në të gjithë shembujt.”⁵⁵ Meqë jemi nisur nga ky shpjegim mbi simbolikën e treshit (i cili na ka hyrë në punë edhe më vonë gjatë interpretimit të poezive të tjera) kemi asocuar në atë se subjekti lirik me këtë nënkupton tri krahinat e Shqipërisë të mbetura jashtë kufijve të saj legjitimë: Kosova, Çamëria dhe qytetet shqiptare të Maqedonisë së Veriut të cilat siç thotë Frojdi synojnë arritjen e një uniteti.

Në pamundësi të realizimit të këtij qëllimi ky tresh mbetet treshi i shkretë, me shtatore carësh në zemrat e tyre, të lidhur me zinxhirë të artë për qafe si subjekti lirik, një tresh i shkretë të cilit nuk i shqitet dimri (vuajtja e të zezat). Në veprën “Ishulli adular” më saktësisht në poezinë “Lulja Alba” miti mbi Afërditën rimerret për të përshkruar bukurinë Arbërisë, atdheut të poetes, vendit që siç e përshkruan autorja Heliosi i derdh me grusht gëzimin, e mundohet që ta gëzojë këtë vend të bukur, ku arka e shpresës është çarë. Arbëria krahasohet me një lule alba e cila ndonëse nën ferrë e nxjerr mbi botë bardhësinë.

Njëjtë si Arbëria, e cila ndonëse e shtypur përsëri arriti t’ia tregojë botës vlerat e saj. Shtypësit ndonëse e varfëruan dhe ia vodhën shpresat nuk mundën që t’ia humbin asaj as bukurinë dhe as vlerat. Arbëria mbetet për subjektin lirik vendi ku Erosi hedh tufa me shigjeta e buzëqeshje- një vend i dashurisë, bukurisë dhe jetës. Në poezinë “Qëndismë” të po kësaj vepre, autorja ka rimarrë mitin mbi Afërditën për ta paraqitur atë si mësuese që ia mëson Arbërisë zejet e bukura. Asaj Arbërie të cilën e kishin shkretuar të huajt (tërë shkretëtira ka hyrë në kazanin e zjarrit të vapës hadjane⁵⁶), asaj Arbërie të cilën të gjithë gazetaret e botës e lëvdojnë duke e krahasuar me një copë qiell të kaltër si një tërësi e paqes.⁵⁷

⁵⁴ Dhama Todt, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 19.

⁵⁵ Freud, Sigmund, *Mbi letërsinë dhe artet*, Fan Noli, Tiranë, 2005, f. 35-36.

⁵⁶ Ahmeti Lindita, *Ishulli adular*, Shkupi, Shkup, 1996, f. 18.

⁵⁷ Ahmeti Lindita, *Ishulli adular*, Shkupi, Shkup, 1996, f. 19.

Por, këtë qiell të kaltër subjekti lirik e sheh të pushtuar nga djemtë e shtemët të Tanatosit i cili siç thuhet në poezi sillet si nikoqir mendjemadh në tempullin e Redonit. Pra, djemtë e Tanatosit na asocojnë në pushtuesit të cilët e patën shkretuar Arbërinë, ia kishin vrarë shpresën e silleshin si zotë të vendit. Mirëpo siç edhe i përshkruan autorja këta njerëz ishin të shtemët dhe nuk mund të dëgjonin se si zërin e shuar të popullit po e bënte të dëgjohej mësuesja Afërditë e cila në këtë rast është simbolikë e gjuhës si bartëse dhe ruajtëse e kulturës e identitetit, e as nuk arrinin të shihnin se “në qiellin e kaltër ka plot yje që nuk duken”, pra ka plot të rinj të zotë që do ta shpëtojnë vendin nga kjo mizori.

Në poezinë “Vjeshta në vjershë” Afërdita i ndihmon subjektit lirik që ta vështrojë vjeshtën me ngjyra të bukura, begati e mollëkuqe, e të përgatitet për dimrin të cilin nuk mund ta kapërcejnë të gjithë. Pra Afërdita tenton ta vetëdijesojë subjektin lirik për të mirat që posedon duke e paralajmëruar se ditët e vështira nuk kalohen lehtë nëse nuk i ruan e i çmon ato që ke, prandaj subjekti lirik e kap për jake çunin syshkruar që ta kalojë në pranverën tjetër. Pra shohim një përpjekje të dëshpëruar të subjektit lirik që kërkon ta ruajë frymëzimin dhe forcën që të mund t’i mbijetojë vështirësive të jetës e të shohë edhe pranvera të tjera edhe ditë të tjera të bukura.

Në poezinë “Portreti Flora Brovinës me kokën lartë” miti mbi Afërditën është rimarrë për të treguar që Afërdita ishte brenda Florës, heroinës që në kohën e luftës në Kosovë, mbrojtë dhe u doli zot të gjitha grave dhe viktimave të dhunës. Heroinës që kontribuoi për shoqërinë shqiptare qoftë si pediatre, qoftë si poete, qoftë si mbrojtëse e të drejtave të grave. Subjekti lirik në poezinë e dhënë iu drejtohet cerberëve (serbëve që e burgosën) se pavarësisht përpjekjeve të tyre për të shuar zërin e kësaj heroine dhe zërin e këtij vendi, ajo, Afërdita dhe Harmonia do të këndonin amshueshëm nën dardhë. Përfshihet edhe figura e Harmonisë që të tregohet për lashtësinë e prejardhjen fisnike të shqiptarëve.

Në veprën “Vetë përballë Erosit” miti mbi Afërditën është rimarrë në poezinë “Shtëpia e verdhë”. Në këtë poezi subjekti lirik i lutet Afërditës ta çojë lart oxhakun e shtëpisë e ta ndezë brenda saj zjarrin e madh të dashurisë. Miti rimerret për të ndriçuar popullin për humbjet që pëson në kulturë dhe rrezikun që i kanoset në rast të humbjes së të vetmit element që i mban gjallë dhe bashkuar pjesët e copëtuara të Shqipërisë, gjuhës. Subjekti lirik flet për shtëpinë e verdhë në të cilën ka : “mobilitet të moçme, qilima, perde të rralla, tavolinë me gdhenda dibrane , makinë shkrimi të braktisur, libra, radio në kërkim të këngës së humbur, qirinj që mbahen ndezur nga fryma e Serembes, katër filxhanë të shkapërderdhur e fqinj të pashmangshëm që e venë veshin në mur e na dëgjojnë si marrin frymë si dhe fëmijët e tyre që s’duan t’ia dinë për Hypnosin e as për shtatin e munduar të subjektit lirik e marshojnë si Pani në tri anë e mbi kokën e subjektit lirik.”⁵⁸

Menjëherë pasi të lexohet poezia, lexuesit të vëmendshëm do t’i bjerë në sy që autorja flet për katër filxhanë të shkapërderdhur. Ky kuatrenitet kjo rëndësi që i jepet shifrës katër, është në vetvete një ide e çuditshme, që megjithatë luan një rol të rëndësishëm në shumë besime dhe filozofi. Krishterimi e ka zëvendësuar me nocionin e trinitetit.⁵⁹ Megjithatë në këtë rast katër filxhanët na asocojnë në Shqipërinë e ndarë në katër vilajete. Të copëtuar në katër copë si katër filxhanët e shkapërderdhur nëpër dhomë.

Megjithatë Shqipëria në të cilën na asocon shtëpia e verdhë vazhdon të ruajë brenda vetes mobilitet të vjetra, të çmuara e të mbuluara nga pluhuri. Shqipëria pra ka lënë në harresë vlerat e saj, trashëgiminë kulturore e historike, e ka lënë atë të mbulohet nga pluhuri i harresës. E për këto vlera e bukuri flasin vetëm librat të cilët i ndriçon kandili i Serembes. I cili diti që në vjershat e tij të bukura lirike të lavdërojë vlerat e Shqipërisë dhe figurat e shquara historike të këtij vendi siç ishin

⁵⁸ Ahmeti, Lindita, *Vetë përballë Erosit*, Brezi 9, Tetovë, 2004, f. 109- 12.

⁵⁹ Jung, Carl G, *Ese mbi gjurmimin e pavetëdijes*, Fan Noli, Tiranë, 2004, f. 99.

për shembull Ali Pashë Tepelena e Dora D'Istria. Në poezi përmenden fqinjët e pashmangshëm që dëshirojnë të vjedhin pasurinë, tokën e historinë e këtij vendi. Fqinjët që nuk e njohin Hypnosin pra që nuk bëjnë gjumë aq sa plane kundër Shqipërisë. Fqinjë që sulen si Pani, pra duke sjellë shkatërrime e vuajtje në këtë tokë, që sulmojnë nga të tria anët e që nuk duan t'ia dinë fare për vuajtjen e stërzgatur të këtyre njerëzve të këtij kombi.

Në poezinë “Prizreni” të veprës “Dhoma pa derën dalëse” miti mbi Afërditën është rimarrë për të folur për bukurinë e Prizrenit. Në këtë vend magjepsës siç e përshkruan autorja Prizrenin, edhe Heliosi ndalet në zenit dhe s'i ecet më tej. Bukuria e Prizrenit, lumi, malet, kalaja, lashtësia e magjia nuk kanë të krahasuar, në këtë vend edhe trumcakët e mbajnë pezull dilizhansën e perëndeshës së bukurisë, Afërditës.⁶⁰ Miti mbi Afërditën është rimarrë edhe në poezinë “Ndjenjat”. Këtu Afërdita rikthehet në kuptimin e perëndeshës së dashurisë. Ajo i mbush me ndjenja vashat e reja, ndjenja të cilat shpërthejnë me mundim dhe bien në asgjë. Poetja flet për dashuritë platonike, për dashuritë e pamundura rinore, dashuritë që përplasen në asgjë e që megjithatë i mbajnë me shpresë të rinjtë.

Rimarrje të të njëjtit mit kemi edhe në veprën “Mështeknaja e babait”. Në poezinë “Miku im” Afërdita zbret në mesin e fijeve të barit ku subjekti lirik ka lëshuar vargjet e bardha të dashurisë, në mështekna, e goditur nga Erosi i biri i saj ajo vuan dashurinë për Adonisin, të cilin e ka vrarë një derr i egër, e i mallëngjen me vajin e saj gjethet e bunglës, lepujt, pëllumbat e egër dhe përroin malor. Atë e ngushëllojnë të bijat haritat dhe ajo i lutet Zeusit t'ia kthejë Adonisin, i cili ia premtonte atë vetëm në verë. Nëse do të lexohej poezia me tjetër sy do të vërehej se autorja e rikthen mitin e humbjes së Adonisit për të dhënë të kuptohet humbja e territoreve shqiptare, vaji i Afërditës simbolizon vajin e shqiptarëve, derri i egër simbolizon të huajt që e ndanë dhe e vranë atë.

Erosi biri i Afërditës me shakanë që ia bëri nënës së tij simbolizon vetë shqiptarët e shitur me të keqen që ia bënë mëmëdheut, haritat e bukura - bijat e mira që ndihmojnë nënën, simbolizojnë gjuhën, kulturën dhe intelektualët e shqiptarë që ruajtën edhe atë pjesë Shqipëri që është dhe mbrojtën me zell edhe atë që duhej të ishte. Figurën e Afërditës e gjejmë edhe te “Shtegtimi i Parisit” në pamjen e perëndeshës e cila i ofron princit Paris të bukurën e dheut nëse ai do të vendoste që ta zgjidhte atë për perëndeshën më të bukur nga tre perëndeshat Hera, Atena dhe vetë Afërdita.

Këtu Afërdita shfaqet si një grua dinake plot lajka e dredhi e cila, i ofron Parisit dhuratën më të çmuar për zemrën e tij – gruan më të bukur në botë Helenën. Ajo bashkëpunon me të birin Erosin për të ndezur në zemrat e tyre dashurinë për njëri-tjetrin. Autorja e rimerr mitin e mollës së sherrit për të shpalosur cilësitë e njerëzve lakmitarë si Parisi që lakmojnë atë që nuk është e tyre, pra siç ai lakmoi Helenën gruan e Menelaut dhe cilësitë e njerëzve të tjerë si Afërdita që bëjnë gjithçka, shfrytëzojnë gjithkënd për qëllimet e tyre, për të kënaqur egon e tyre.

Në poezinë “Ku je” shohim të përmendur jo vetë mitin mbi Afërditën por mbi brezin e Afërditës që ishte atribut i përhershëm i hyjneshës në të cilin fshihej sekreti i nurit të saj.⁶¹ Këtu ky motiv rimerret për të treguar dëshirën e madhe të subjektit lirik për t'i ndriçuar rrugën të dashurit (shpresës së mirë) drejt saj me diçka aq të ndritshme hirplote sa brezi i Afërditës.

Tek “Bari i tamblit” përmendet prania hijes së Afërditës, hije kjo që ia shton magjinë hapësirës lirike ku subjekti lirik rigjen vetveten, lirinë, kënaqësinë, mes fijeve të barit të tamblit, bunglës, Erosit, këngës nga fyelli i Panit nën dirigjimin e Apolonit, farës së groshës nga përralla, mes luleve që duket sikur kanë dalë nga kopertina e “Bagëti e Bujqësi”, mes magjisë së prillit që duhet të vijë (kohës së shumëpritur për bashkim) dhe botës së Virxhinia Vulfit ku ishte gjelbër në një blerinë në një tjetër vrugë, ku dëgjohet klithma e mështeknajës (vaji i popullit), ku duhet

⁶⁰ Jung, Carl G, *Ese mbi gjurmimin e pavetëdijes*, Fan Noli, Tiranë, 2004, f. 100.

⁶¹ Dhama Todi, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 20.

larguar së këndejmi dora që ia zë dritën aurorës (të huajt që s'lejojnë bashkimin, lulëzimin e Shqipërisë), ku ëndërrohet që prilli të dalë si feniksi (koha që do të vijë e cila pa dyshim do të jetë një mijë herë më e bukur se e kaluara), poezia bart peshën e pritjes që të ndodhë ajo që ka gjakuar durimi, të shpërthejë anakënd mështeknasë liria, dhe bari i tamblit e gjithçka të gëzojë e lirë në gjuhën amë. Siç mund të kuptohet miti rimerret për të folur për bukurinë e vendlindjes së subjektit lirik që pavarësisht gjithçkaje rronte duke pritur kohën për bashkim me pjesën e mbetur jashtë kufijve, ku mështeknaja e cila klith na asocion me vajin e popullit për fatin e tyre, dora që ia zë dritën aurorës na asocion në ata që nuk lejojnë bashkimin e Shqipërisë, djegës së subjektit lirik.

2. Dodona

Krahas mitit mbi Afërditën në krijimtarinë e Linditës shpesh rimerret edhe miti mbi Dodonën (Orakulli më i vjetër, që sipas historianëve të vjetër ndodhej në vendin e molosëve (fis ilir i Shqipërisë së Jugut) 20km në veri të Janinës. Dëshmitë letrare e paraqisnin Dodonën si një qendër fetare shumë të vjetër të pellazgëve. Aktiviteti i saj ka qenë shumë madh. Herodoti thotë se e gjithë teologjia pellazge rrjedh nga Dodona. Odiseu iu drejtua Dodonës për të mësuar si mund të kthehej në Itakë atë e pyeti edhe Eneu.)⁶²

Miti mbi Dodonën rimerret në disa poezi e në disa vepra. Në veprën “Ishulli adular” në poezinë “Diku ndërmjet” miti rimerret për t’ua kujtuar shqiptarëve e armikut që tentonte t’i përçante ata duke përdorur fenë, për atë se shqiptarët kishin pasur një fe, një klerik dhe një tempull përpara se ta kishin të tjerët, një tempull aq të lashtë e të rëndësishëm në të cilin kishin ardhur të këshilloheshin mbretër legjendarë. Me një fjalë t’ua kujtonte më shumë shqiptarëve që nuk duhej të harronin se ishin trashëgimtar të një kulture të lashtë e s’duhej ta linin veten të gënjuheshin nga klerikët pitonë.

Në veprën “Brezi i Zonjës” në poezinë “Gratë tona para Dodonës”, miti rimerret për të thënë se fati i Shqipërisë ishte fati i parashikimeve të orakujve të Dodonës, i pashmangshëm, por trimat e saj ishin ata që e bënë këtë përballje me fatin lavdi. Në veprën “Dhoma pa derën dalëse” miti rimerret në poezitë “Shtëpia ime” dhe “Nëse e kërkon fjalën e rrallë shqipe”. Në poezinë “Shtëpia ime” miti rimerret për t’iu treguar ushtarëve të huaj se nuk mund ta pushtonin dhe asimilonin Shqipërinë, sepse rrënjët e saj ishin të forta. Sepse kishin një gjuhë nga më të vjetrat që dëshmon për to dhe Dodonën e lashtë e cila ishte prova e lashtësisë së kulturës së tyre. Për t’iu kujtuar pra, që ajo ndonëse lëkundet kurrë nuk rrëzohet, sepse i ka rrënjët e forta që e mbajnë në këmbë, gjuhën dhe kulturën.

Në poezinë “Nëse e kërkon fjalën e rrallë shqipe”, miti rimerret për të dëshmuar lashtësinë e gjuhës shqipe, për të dëshmuar se lisi i Dodonës i fliste shqip orakullit. Prandaj subjekti lirik i bën thirrje kujtudo që kërkon fjalën e rrallë shqipe atë ta kërkojë në kokrrat e mollëve të Tetovës, në këngën e nënës, në rrënjët e lisit të Dodonës.⁶³ Pra ta kërkojë atë në popull, sepse ai me zili ruan origjinën e vet. Ky mit rikthehet në disa poezi edhe në veprën “Mështeknaja e babait”.

Në poezinë “Shqipëria ime” ky mit rikthehet për të dëshmuar lashtësinë e vendit, kulturës dhe gjuhës. Në poezi subjekti lirik flet për Shqipërinë në të cilën ende dëgjohet tregimi mbi gurrën e Dodonës, për Shqipërinë me mijëra ngjyra, me këngët që janë vazhdim i këngës së linit, që është trëndafilnajë e vendosur mbi shkrepë e djega e subjektit lirik.⁶⁴ Pra për një Shqipëri që dëshmon për lashtësinë dhe kulturën e vet, përmes këngëve, gjuhës dhe kulturës fetare.

⁶² Dhama Todi, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988, f.71-72.

⁶³ Ahmeti, Lindita, *Dhoma pa derën dalëse*, Logos A, Shkup, 2015, f. 129.

⁶⁴ Ahmeti, Lindita, *Mështeknaja e babait*, Portalb, Shkup, 2015, f. 63.

Pra, miti rimerret për të dëshmuar ekzistimin e një feje a besimi të veçantë dhe të lashtë të popullit tonë, i cili besim si trashëgim kishte lënë këtë tempull.

3. Aurora

Një tjetër mit që shpesh rimerret dhe risemantizohet në krijimtarinë e Lindita Ahmetit është edhe miti mbi Aurorën (Hyjneshë romake që personifikonte agimin, lindjen e ditës së re. Poetët e identifikuan me Eojën greke dhe i atribuuan të gjitha legjendat që kishin lidhje me të. Ashtu si Eoja, Aurora konsiderohej si vajza e Hiperonit dhe motra e Heliosit që u sillte dritën e mëngjesit. Paraqitej zakonisht e mbuluar me rreze, hipur në një qerre që tërhiqej nga kuaj të bardhë, e cila shkonte përpara qerres së Diellit.)⁶⁵ Ky mit rimerret në disa poezi.

Në veprën “Brezi i zonjës” miti mbi Aurorën është rimarrë në poezinë “Gratë tona para Dodonës”. Aurora mundëson që të zbulohet pamja e Dodonës me gratë që lexojnë gjethet e dushkut (fatit) të cilat e parathënë fatin e Shqipërisë: luftërat e shumta dhe viktorian-fitoren me duvakun flamur kuq e zi.⁶⁶ Miti mbi Aurorën në këtë poezi na mundëson që të hidhet dritë mbi të kaluarën e popullit shqiptar dhe zakonet tona të vjetra. Rimarrja e këtij miti është thirrje për të zbardhur për të ndriçuar të kaluarën tonë, për të hedhur dritë mbi të pathënat dhe historinë tonë.

Në veprën “Dhoma pa derë dalëse” ky mit është rimarrë në poezinë “Dora e metaforës”. Në këtë poezi miti rimerret në kuptimin e shpresës për ditë të mira që subjekti lirik pret të vijë, të cilën ajo nuk e sheh asgjëkund. Atë shpresë ajo e pret, sepse e mbyl pikëllimi për atdheun e saj, në të cilin ngadalë fiken gjuha e vatra. Miti është rimarrë si thirrje për ngritje të vetëdijes sonë kombëtare, thirrje për zgjim dhe dalje nga terri e përgjumja. Në poezinë “Petalet e një luleje” Aurora sjell tufatufat dritën dhe bukurinë mbi letrën e poetit (Murat Isaku) e mbi letër fillojnë të çelin fjalët që bëhen urë drite për poetët (Abdylaziz Islami dhe Mustafa Laçi), të cilët ulen në krye të vendit të këngës e dëshmojnë se jemi petale të një luleje.⁶⁷

Siç mund të kuptohet miti mbi Aurorën, është rimarrë si sinonim i dritës që duhet të hidhej për të ndriçuar historinë tonë, qenien tonë, dhe të cilën dritë e sillnin poetët me vargjet e tyre që dëshmonin mbi prejardhjen tonë, që dëshmonin se kemi një gjuhë dhe jemi një komb edhe pse i ndarë. Në poezinë “Poetit Nexhat Pustina” vargjet e poetit sjellin Aurorën dhe e bëjnë blerimin e parë të bëjë muzikë, thua ti Boreu e ngre në këmbë mbretërinë e Kastriotit.⁶⁸ Në këtë poezi ky mit është rimarrë për të përshkruar forcën e vargjeve të poetit që ndriçonin, vetëdijesonin popullin që po i vidhej historia duke klithur “m’i vjedhin gurët”, që hidhnin dritë mbi të kaluarën tonë, lavdinë e Kastriotit dhe mbretërisë së tij apo rëndësinë e shkollimit të fëmijëve.

Në veprën “Mështeknaja e babait” miti mbi Aurorën rimerret në disa poezi. Te “Tregimi i zi” duket sikur buzëqeshja e Aurorës do të kishte qenë e vetmja që do t’i mundësonte subjektit lirik që t’i heqë prangat e zisë dhe të karriges së gurtë që e mbajnë lidhur në një pyll ku frynë nga pesë anë të tregimit të zi, me furtunë nga krahjeta dhe erë bore nga Siberia.⁶⁹ Simbolikisht ajo paraqet shpëtimin, të mirën e një dite e cila del e zezë, shpëtimin nga vitet në nën pushtim, të ftohta e të errëta. Ajo paraqet të mirën që pritet të vijë pas një të keqeje që zgjat shumë, dritën e diellit pranveror që na ngroh pas një dimri të gjatë të acartë, shpresën e mirë.

⁶⁵ Dhama Todi, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 52.

⁶⁶ Ahmeti, Lindita, *Vetë përballë Erosit*, Brezi 9, Tetovë, 2004, f. 20.

⁶⁷ Ahmeti, Lindita, *Dhoma pa derë dalëse*, Logos A, Shkup, 2015, f. 76.

⁶⁸ Ahmeti, Lindita, *Dhoma pa derë dalëse*, Logos A, Shkup, 2015, f. 79.

⁶⁹ Ahmeti, Lindita, *Mështeknaja e babait*, Portalb, Shkup, 2015, fq. 56

Te “Shqipëria ime” Aurorës i besohet “çelësi” që ajo ta shtrijë mbretërimin e saj dhe dritën e saj nëpër Shqipërinë e krijuar në fund të qershorit nga drita e xixëllonjave, ku ulet në fron mbretëresha florë dhe shpërndan erën e mirë të trëndafilave e luleve alba, ku shqiponja e bardhë bën roje në shtëpinë e gurtë të Kadmit e Harmonisë, që u caktuan të jenë të Parët Mitikë që shpikën lule e shpërndanë shkronja për librin e parë nga Sharri, nga Tomori, nga Bjeshkët e Nemuna. Aurorës pra i besohet çelësi i Shqipërisë që ka dalë nga zëri yllësor i Orfeut, që është vendi ku vazhdimisht bredh i biri i Afërditës e pastaj shpërndanë nëpër botë kuptimin e dheut që është sinonim i emrit të tij.

Aurorës i besohet çelësi i vendit të djemve kësulëbardhë që bredhin përfund degës së parë të trungut të gjuhëve, të cilëve u kumbojnë fjalët e u shkëlqejnë si dielli flokët e praruar, çelësi i një trëndafilnaje të vendosur mbi shkrepë ku banojnë shpresat më të bukura dhe ku dëgjohet edhe sot tregimi i gurrës së Dodonës në mënyrë që ajo ta ruaj atë nga errësira (pushtimi). ⁷⁰Përmes Aurorës hidhet dritë mbi të parët mitik, pra prejardhjen tonë, lashtësinë tonë, kulturën, gjuhën e lashtë dhe të veçantë në trungun e gjuhëve, pozicionin e Shqipërisë, një lule mes shkrepash, për Dodonën tempullin e lashtë fetar që është mburoja jonë prej asimilimit.

4. Përfundimi

Duke analizuar arsyet e rimarrjes së këtyre miteve në krijimtarinë e Lindita Ahmetit do të vijmë në përfundim se autorja i rimerr të njëjtat herë për të dëshmuar për kulturën, historinë dhe gjuhën e saj amë e herë për të bërë thirrje për vetëdijesim të popullit për pasuritë e veta të cilat i kishte lënë në harresë dhe të cilat nuk po i mbronte sa dhe si duhej dhe se humbja e të njëjtave është humbje e identitetit kombëtar.

Janë analizuar figura nga tri mitologji (greke - Afërdita, romake - Aurora dhe shqipe - Dodona) për të dëshmuar atë që autorja e jep si mesazh në krijimtarinë e vet “që kulturat më të vjetra kanë mbijetuar duke i dhënë e marrë njëra - tjetrës, duke u frymëzuar nga njëra - tjetra e duke krijuar për njëra - tjetrën modele.” Sepse shohim që këto figura mitologjike u krijuan nga popujt që jetuan në të njëjtën kohë, që luftuan e krijuan në të njëjtën kohë e që u munduan të epërsojnë mbi njëri - tjetrin për të lënë gjurmët më të hershme duke tentuar të fshijnë gjurmët e fqinjëve të tyre, duke tentuar t’i pushtojnë e asimilojnë.

Duke lexuar poezitë e Linditës si dhe duke analizuar mënyrën e rimarrjes së miteve në krijimtarinë e saj, lexuesi i vëmendshëm do të kuptojë që koha mitike kalon shpesh nga ciklike në kronologjike dhe figurat nga mitologjia jetojnë e veprojnë në të njëjtën kohë me poetin. Kjo mënyrë e ndërrimit të kohëve meqë është një temë më e gjerë dhe e veçantë nuk është analizuar në këtë punim. Mirëpo, shpresojmë që ky punim të ngjallë interesin e studiuesve për të analizuar të njëjtën. Përmes këtij punimi shpresojmë të jetë ngjallur kërkësia e lexuesit dhe studiuesit për të njohur më mirë mitet dhe mënyrën se si ato dëshmojnë për origjinën tonë si dhe për të njohur rëndësinë e studimit të tyre.

Referencat

- [1]. Dhama Todi, Fjalor i mitologjisë, Rilindja, Prishtinë, 1988.
- [2]. Freud, Sigmund, Mbi letërsinë dhe artet, Fan Noli, Tiranë, 2005.
- [3]. Ahmeti Lindita, Ishulli adular, Shkupi, Shkup, 1996.
- [4]. Ahmeti, Lindita, Vetë përballë Erosit, Brezi 9, Tetovë, 2004.
- [5]. Jung, Carl G, Ese mbi gjurmimin e pavetëdijes, Fan Noli, Tiranë, 2004.
- [6]. Ahmeti, Lindita, Dhoma pa derën dalëse, Logos A, Shkup, 2015.
- [7]. Ahmeti, Lindita, Mështeknaja e babait, Portalb, Shkup, 2015.

⁷⁰ Ahmeti, Lindita, *Mështeknaja e babait*, Portalb, Shkup, 2015, f. 63.